



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 212, Datë 28.07.2026

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREENSOL” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 49.96 MW**

Në mbështetje të nenit 40, pika 2, gërma “a” dhe 41, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/14 prot., datë 28.07.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GREENSOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 22.05.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 MW.
- Në vijim të këtij aplikimi, bordi i ERE-s me vendimin nr. 158, datë 05.06.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 06.06.2026 dhe 08.06.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 06.07.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1662/3 prot., datë 16.06.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Brenda afatit të procedurës së shqyrtimit, MIE nuk ka përcjellë në ERE ndonjë qëndrim apo informacion që t'ndikojë në vijimin e procedurës së licencimit.
- Me shkresën nr. 1662/4 prot., datë 16.06.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit/informacionit të munguar.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/7 prot., datë 29.06.2026, depozitoi dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Vlen të sqarohet se procedura e licencimit është filluar për centralin fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 49.96 MWp, përbërë nga 76,860 module fotovoltaike me fuqi 650 Wp secili. Nga dokumentacioni teknik i depozituar rezulton se kapaciteti prej 49.96 MWp i referohet fuqisë së instaluar në rrymë të drejtë (DC), ndërsa fuqia nominale e centralit në rrymë alternative (AC), për të cilën është lëshuar miratimi në parim nga OST sh.a. dhe është vlerësuar projekti në kuadër të procedurës së VNM-së paraprake, është 41.29 MW. Për rrjedhojë, vlerësohet që licenca për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të jepet për kapacitetin 41.29 MW.
- Po ashtu, lme shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/5 prot., datë 19.06.2026, shoqëria ka përditësuar projektin, duke përfshirë tanimë dhe veprat ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
- Për sa më sipër, me vendimin nr. 179, datë 29.06.2026, bordi i ERE-s vendosi të ndryshojë vendimin nr. 158/2026, duke pranuar për shqyrtim në këtë fazë vetëm përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë vetëm për fuqinë 49.96 MW, të parashikuar dhe në VKM-në nr. 770, datë 19.12.2025 dhe në Kontratën nr. 602 rep., nr. 164 kol., datë 10.02.2026, së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Në vijim, me vendimin e Bordit nr. 197, datë 21.07.2026, është vendosur pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit për kërkesën e shoqërisë “GREENSOL” për përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në licencën e prodhimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit, deri në marrjen e interpretimit/sqarimit të nevojshëm nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Ky pezullim nuk prek shqyrtimin e kërkesës për licencimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, për të cilën procedura vijon në mënyrë të pavarur.
- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

Shoqëria “GREENSOL” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kontraten nr. 602 rep., nr. 164 kol., datë 10.02.2026, “*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike, me kapacitet prodhues 49.96 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, nga shoqëria “GREENSOL” sh.p.k.*”.
- Është pajisur miratimin në parim për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës nr. 1994/2 prot., datë 23.05.2025, të shoqërisë “OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT” (OST sh.a.).
- Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, më datë 09.01.2025 për të zhvilluar projektin për zhvillimin e projektit: “*Ndërtimi, Zhvillimi, Mirëmbajtja & Operimi i Parkut Energjetik Fotovoltaiik _ Bistricë*”.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e aplikimit, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “GREENSOL” sh.p.k. është në përputhje me objektin e kërkesës për licencim dhe mbulon elementët kryesorë teknikë, juridikë dhe mjedisorë të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet 41.29 MW.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 41, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka bërë me dije se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25-30 vjet, si e tillë, vlerësohet se licenca e shoqërisë do jetë e vlefshme për 25 vite (bazuar në dokumentacionin teknik të aplikimit), si dhe shoqëria duhet të bëjë përditësime të projektit të saj në lidhje me jetëgjatësinë e centralit në vijim.
- Shoqëria ka marrë miratimin në parim, nëpërmjet shkresës së OST sh.a., me nr. 1994/2 prot., datë 23.05.2025, për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit, por nuk ka nënshkruar ende marrëveshjen përfundimtare. Si e tillë, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë, që përpara fillimit të operimit të centralit, të depozitojë në ERE Marrëveshjen e Lidhjes me rrjetin e transmetimit.
- Shoqëria ka parashikuar që centrali fotovoltaiik do të hyjë në operim në fund të vitit 2028, duke u bazuar në pritshmërinë që Leja e Zhvillimit dhe Leja e Ndërtimit të miratohen përpara muajit tetor 2026 dhe në afatin dyvjeçar të ndërtimit të përcaktuar në grafikun e punimeve. Si e tillë, duke qenë se referuar VKM-së nr. 770/2025, afati maksimal për ndërtimin dhe vënien në punë të centralit është data 19.12.2028, vlerësohet që të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda këtij afati.
- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet t’i lihet asaj kusht që, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.
- Shoqëria disponon vendimin për VNM paraprase, datë 09.01.2025, vlefshmëria e të cilit përfundon më datë 09.01.2027. Duke qenë se shoqëria ka deklaruar se nuk ka filluar ende punimet për ndërtimin e centralit, vlerësohet t’i lihet kusht që të njoftojë ERE-n për fillimin e punimeve dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës brenda datës 09.01.2027.
- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
- Në përfundim të shqyrtimit të aplikimit dhe dokumentacionit të depozituar, vlerësohet se shoqëria “GREENSOL” sh.p.k. ka përmbushur kushtet ligjore dhe rregullatore për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet 41.29 MW, me detyrimin për të respektuar kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë vendim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “GREENSOL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 41.29 MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, për një afat 25-vjeçar.
2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE Marrëveshjen e Lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit të nënshkruar me OST sh.a.

3. Shoqëria duhet të raportojë në ERE për fillimin e punimeve të centralit dhe të përditësojë projektin në lidhje me jetëgjatësinë e centralit brenda datës 09.01.2027.
4. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 19.12.2028.
5. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.
6. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GREENSOL” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a., dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI